




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA




ZYRA E PROKURIMIT

Nr.002/2022

Nr. Protokolli: 05/2022

<b>Për:</b>	<b>Lirim Kicaj B.I., Greikoc Suharekë</b>
<b>Kopje:</b>	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
<b>Nga:</b>	Bujar Kuçi, Shef i zyrës së prokurimit
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b>
<b>Datë:</b>	<b>16.02.2022</b>



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **13.02.2022** të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Lirim Kicaj B.I., Greikoc Suharekë**, për procedurën: **Shërbimet e transportit sipas vitit kalendarik 2022 Lot/pjesë 7- LOT/PJESA 7**, Nr. të Prokurimi: **624-21-9090-2-2-1 & 624-021-160-221** nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **Aprovohet Pjesërsht** kërkesa për ri-shqyrtim e datës **13.02.2022** e parashtruar nga Operatori Ekonomik **Lirim Kicaj B.I., Greikoc Suharekë**, për procedurën: **Shërbimet e transportit sipas vitit kalendarik 2022 Lot/pjesë 7- LOT/PJESA 7**, Nr. të Prokurimi: **624-21-9090-2-2-1 & 624-021-160-221**.
- II. **Anulohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 09.02.2022 dhe lënda kthehet në ri-vlerësim**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 13.02.2022 ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim nga Operatori Ekonomik **Lirim Kicaj B.I., Greikoc Suharekë**, për procedurën: **Shërbimet e transportit sipas vitit kalendarik 2022 Lot/pjesë 7, për LOT/PJESA 7, Nr. të Prokurimi: 624-21-9090-2-2-1 & 624-021-160-221**

Pas verifikimit të të dhënave në lidhje me pretendimet ankimore të kërkesës për ri-shqyrtim të paraqitura nga ana juaj, ne kemi konstatuar se kërkesa juaj është pjesërisht e bazuar për faktin se OE i propozuar ka ofuar një reference siq është kërkuar me FDT, por pas pretendimeve tuaja kemi konstatuar se referenca e OE të propozuar duhet të sqarohet konform nenit 72 të LPP-së në mënyrë që vlerësimi të jetë konform nenit 59 të LPP-së.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.  
Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Shef i zyrës së prokurimit  
Bujar Kuçi

